



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Kuvendi – Skupština – Assembly



**Kuvendi Kombëtar**  
**Republika e Bullgarisë**

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

### NË MES TË ADMINISTRATËS SË ASAMBLESË KOMBËTARE TË REPUBLIKËS BULLGARISË

DHE

### ADMINISTRATËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Me qëllim të krijimit të lidhjeve ndërparlamentare dhe rritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes të shërbimeve të administratës së dy parlamenteve, Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë Kombëtare të Republikës së Bullgarisë dhe Sekretari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas marrjes së pëlqimit të kryetarëve të dy parlamenteve, afirmojnë vullnetin për të nxitur bashkëpunimin dypalësh në fushat e mëposhtme:

1. Binjakëzimin e strukturave të shërbimeve të administratës të dy parlamenteve;
2. Bashkëpunim mes shërbimeve për media dhe marrëdhënie me publikun, duke përfshirë qasjen e mediave në hapësirat e Kuvendit, qasjen e publikut (qytetarëve) në punën e Kuvendit, si dhe sektorin e publikimeve;
3. Bashkëpunim mes shërbimeve përkatëse për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare duke përfshirë: avancimin e rregullave dhe praktikave për protokoll, organizimin e konferencave ndërparlamentare, si dhe përfshirjen e teknologjisë informative në këtë fushë;
4. Shkëmbimin e ndërsjellët të eksperiencës dhe informacionit, përmes vizitave studimore të zyrtarëve në parlamentet përkatëse;
5. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të shërbimeve dhe projekteve të përbashkëta pranë institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe donatorëve;
6. Bashkëpunim në çështje të tjera me interes reciprok për dy parlamentet;

Të dyja palët bien dakord për nevojën e mbajtjes së kontakteve ndërmjet administratave të tyre dhe konfirmojnë gatishmërinë e tyre për shkëmbim të ekspertëve qoftë në mënyrë bilaterale qoftë në ndonjë strukturë tjetër, në kuadër të bashkëpunimit sipas planit financiar të kuvendeve përkatëse.

*Ky pajtim nuk implikon asnjë përkushtim financiar nga asnjëra palë e memorandumit, secila nga të dy administratat aprovojnë se ata do të përkrahin.*


Ky memorandum do të hyjë në veprim në mënyrë të menjëhershme. Ai mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.

Ky Memorandum Bashkëpunimi është e një natyre tërësisht rekomanduese. Ajo nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.

Përfaqësuesit e lartë zyrtarë të dy parlamenteve bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi në Prishtinë të Republikës së Kosovës, me datë 20 mars 2012.

Sekretari i Përgjithshëm  
i Kuvendit të Kosovës

**Ismet Krasniqi**



Sekretari i Përgjithshëm  
i Kuvendit Nacional  
të Bullgarisë

**Ivan Slavchov**

